

**V E N D I M**  
**Nr.478, datë 29.7.1998**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 86 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Krijohet në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit “Komisioni i transporteve rrugore”.

2. Komisioni i transporteve rrugore përbëhet nga:

|                                                                    |                 |
|--------------------------------------------------------------------|-----------------|
| - Zëvendësministri i Punëve Publike dhe Transporti                 | kryetar         |
| - Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit të Transportit               | zëvendëskryetar |
| - Drejtori i Institutit të Transporteve                            | anëtar          |
| - Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve                 | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit  | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave                           | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Rendit Publik                       | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit              | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave            | anëtar          |
| - Përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Industrisë dhe Tregtisë       | anëtar          |
| - Përfaqësues nga shoqatat e transportuesve                        | anëtarë         |

Me kërkesën e kryetarit, në mbledhjen e komisionit, në vartësi të problemeve që përmban rendi i ditës, mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të institucioneve studimore—shkencore, që lidhen me fushën e transporteve rrugore.

3. Komisioni i transporteve rrugore është organ konsultativ i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, që jep mendime për koordinimin dhe harmonizimin e politikës së zhvillimit të transporteve rrugore me llojet e tjera të transportit, si dhe me politikën e përgjithshme të zhvillimit të ekonomisë kombëtare.

Komisioni i transportuesve rrugorë ka të drejtë të propozojë dhe të japë mendimin për nxjerrjen ose ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore, në zbatim të politikave të zhvillimit të transporteve rrugore dhe për përshtatjen e tyre me rregullat e organizatave ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare.

4. Komisioni merr në shqyrtim dhe jep mendime për problemet që kanë lidhje me:

- strategjinë e zhvillimit perspektiv të transporteve rrugore, në tërësi, si dhe të llojeve të veçanta;
- drejtimin, organizimin dhe sistemet e informacionit në transportet rrugore;
- përmirësimin dhe përsosjen e cilësisë së shërbimeve të transporteve rrugore;
- shtrirjen e teknologjive të përparuara në rritjen e efikasitetit të përdorimit të aftësive transportuese;
- trafikun e lëvizjes së mjeteve të transporteve rrugore;

- probleme të tjera, që kanë lidhje me transportet rrugore, koordinimin me llojet e tjera të transportit, me infrastrukturën rrugore, sigurimin e lëvizjes, etj.

5. Komisioni i transporteve rrugore mbledhet një herë në 6 muaj. Me kërkesën e kryetarit, ose të njërit prej anëtarëve të tij, komisioni mund të mbledhet edhe para këtij afati.

6. Rregullorja e funksionimit të komisionit të transporteve rrugore dhe ajo e sekretarisë së tij

miratohet nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**